



Lith. de Ducaume

ALI — PACHA

Korrespondenca

DY FJALË TË AUTORIT

E kam pasur pérherë të vështirë të besoj se Civilizimet kanë pasur një ditë të caktuar, unike lindjeje, në këtë apo atë shekull, në këtë apo atë vit. Përkundrazi, kam gjykuar se qytetërimet lindën pikërisht atëhere kur njeriu u ndërgjegjësua se, më shumë sesa ajo që gjente të gatëshme në natyrë, të krijonte, dhe mbi të gjitha të ruante atë që të tjerët kishin krijuar me parë. Ndërsa, shkatërimet e vlerave dhe të trashëgimisë të të parëve nuk kanë qënë asgjë më shumë sesa reminishenca të barbarisë. Dhe historia ka treguar se jo pak popuj të rënë në apati, në pasivitet, që u ka munguar përpjekja dhe vetëdija pér krijimin e vlerave, apo më keq kanë shkatërruar trashëgiminë e të parëve, janë larguar nga rruga e civilizimit, kanë humbur identitetin dhe janë shuar nëpër kohe.

Prandaj, çasti dhe procesi i krijimit të vlerave, pér më tepër i atyre shpirtërore është momenti i zgjimit të madh, i hopit të magjishëm, i udhëve të ngjitjes dhe prosperitetit të një populli, agu i civilizimi të tij.

Dekadat e fundit të shekullit të XVIII dhe të fillimit të shekullit të XIX, pér ne shqiptarët, përkojnë pikërisht me hopin e madh cilësor, të krijimit dhe prodhimit të vlerave materiale, të veprave të shumta me karakter urban, social, kulturor, ushtarak, arkitekturik, infrastrukturor, relixhioz, etj. Por, mbi të gjitha ato janë dekadat e fillimit të krijimit të një pasurie të madhe shpirtërore, dokumentare të papërsërëtëshme, të shenjave të shumta të lëna nga mellani në letër apo më mirë të themi të shenjave të lëna nga mëndja dhe shpirti i shqiptarëve të kohës, në dorëshkrime, pér të n'a treguar ne gjeneratave të shekujve XX, XXI dhe atyre që do të vijnë më pas, se kush qenë, çfarë bënë, çfarë mendonin, çfarë ëndëronin dhe çfarë tentuan këta njerës.

Këto prurje dokumentare veç vlerave të tjera shumëplanëshe, janë padyshim aktet më domethënëse të një epoke të re, janë

Ali Pasha

pasqyrë dhe elementët bazikë të koshiencës shtetformuese dhe infrastrukturës nationale që kish filluar të lindëte dhe ngjizej tek shqiptarët. Dhe meritën e madhe për këtë epokë tronditjesh, prurjesh dhe transformimesh të mëdha civilizuese e ka Ali Pashë Tepelena, firmën e të cilit mbajnë mbi vehte jo vetëm ato kohë, por edhe të gjitha dokumentet e këtij vëllimi, materie autentike dhe pasuri e rrallë për historinë dhe trashëgiminë tonë.

Irakli Koçollari

Korrespondenca

DOKUMENTET E KANCELARISË SË ALI PASHËS 1747 – 1803

Dokumenti Nr. 6

Kozhani, 13 Shkurt 1784

Dokumenti me nr. 6 është një letër e kryepleqve të Kozhanit drejtar “Sulltan hanum Fatmës”, pronare e mukatasë (taksësturq.) së vendbanimeve të tyre. Deklarojnë se janë të kën-aqur prej “zabitit që na dërgove, Osman agait” dhe i luten që të vazhdojë t’i mbrojë, pasi vetëm duke qënë ajo e fuqishme “mund t’i mbrojë prej njerëzve të këqij”. Megjithatë Rushi Kon-dorushis dhe disa të tjera prej atyre që nënshkruajnë arxuhallin (letrën) në favor të Osman agait grupohen si një fraksion pro Ali Pashës, çka spjegon paraprakisht edhe faktin se përse ky dokument gjendet në Arkivin e Ali Pashës. (Pjesë të këtij informacioni janë botuar edhe nga J. Hionidhi: “Ta engrafa”, f. 223)

E madhërishmija dhe jetëgjata Sulltan hanum Fatme efendimizen, zonja mëmë mëshirëmadhe, madhërisë tënde skllavërisht i përulemi, ne të bindurit dhe besnikët shërbëtorët e turajatë e Kozhanit, dhe lusim të madhërishmin zot të të japë shëndet dhje jetë të gjatë dhe shtojë pushtetin tënd që të kemi për ndihmë në fatkeqsi dhe për shërbime për të gjitha nevojat dhe hallet tona.

Pas përulesisë tonë skllavërore vjmë dhe mbi të gjitha të falenderojmë për zabitin që na dërgove, Osman aganë, i cili me të mbritur këtu, në vendin tonë, në Kozhan, me të parë fatkeqësitë dhe gjendjen tonë të mjeruar, si një prind i mirë që do fëmijët e tij, ndjeu keqardhjen dhe menjëherë na ndihmoi duke na u gjendur menjëherë për nevojat tona, pa i bërë veprimet e tij pa më të voglin interes, por vetëm nisur prej mirësisë dhe pastërtisë së tij. Ai tregoi dhe vazhdon të tregojë se na

Ali Pasha

dashuron dhe dëshiron përmirësimin e kushteve dhe të gjendjes në krahinën tonë, edhe ne s'ka dyshim që jemi shumë të lumtur, mirën-johës dhe e falenderojmë për përpjekjet që ai bën.

Për këtë arsyen i lutemi të madhërishtes mëmë që ta ketë në vëmendje dhe në sytë e saj, për ta ndihmuar atë në çdo rast, dhe nëse qëllon që të vijë dikush pranë jush dhe të thotë ndonjë fjalë të keqe për Osman aganë e Kozhanit, apo edhe nga vende të tjera, (pasi njerëzit shpirtliq nuk mungojnë), të mos i besoshi të paudhëve asnijëherë, pasi njerëzit e këqinj dhe gjenieshtarët përherë i ndoqi dhe i ndëshkoi me dorën e tij të gjatë, pasi ai do qetësinë dhe rregullin në krahinat tona. Në të kundërt, përsëri njerëzit e këqinj do të gjejnë terren dhe bashkëpunëtorë që të hakmerren ndaj zabitit tonë. Osman agai është nevoja e jonë, dhe ne të paktët nëse përcahemi do të bëhet vëndi ynë përsëri mos më keq pasi fuqi nuk na ka mbetur.

Për këtë të lutemi përsëri, që zabitin tonë Osman aganë, të mos e lësh ta prekë kush, por në të kundërt ti japësh fuqi edhe më të madhe, që të mundë me fuqinë tdhe ndihmën tënde të na sigurojë dhe të na ruajë nga njerëzit e këqinj dhe ne duke njohur mirësinë tënde urojmë të kesh jetë të gjatë.

Jani Papaluja	Rushi Misiu	Laçko Dhimu	Rushi Kondorushi
Jorgji Theodhoru	Jorgjios Mihal	Markos Zizxi	Qiro Strefani
Janis Gjeorgjiu	Jorgjios Agora	Jani Harizi	

Dokumenti Nr. 9

Sudena e Poshtme, 15 Mars 1788.

Dokumenti me nr. 9 është një Marrëveshje e banorëve të Sudanës

Korrespondenca

së Poshtme, (krahina e Dodonës) me anë të së cilës deklarojnë se "e bënë fshatin e tyre agaliq për Ali Pashë efendinë tonë për dyqind groshë". Interes paraqet lloji i mbrojtjes që kanë Suden- et e Poshtme prej agai pashait të tyre - që t'i mbrojë, sikundër thonë ata prej "spahijve", domethënë për të drejtat e timareve të fshatit të tyre dhe nga shlyerjet e detyrimeve, prej të cilave rëndohet periodikisht fshati. Letra e mëposhtëme është dokumenti i parë që i takon në mënyrë të padiskutueshme Arkivit të Ali Pashës dhe njëkohësisht i pari ku përmendet ky i fundit si Pasha i Janinës dhe si e tillë përbën një dëshmi të rëndësishme për kohën kur përmendet grada dhe funksioni i tij. Të gjithë studiuesit e gjertanishëm, për shkak të mungesës së dokumentacionit zyrtar, e vendosin Ali Pashën në funksionin e Pashait në Janinë, me përafri, më 1788, dhe më të shumtët në fund të këtij viti. Përashtim nga ky mendim bën studiuesi rus Grigori Ars tek vepra "Alvania- Epiro....", në faqen 115, i cili duke iu referuar kësaj pasigurie, apo paqartësie, përmend se ai në kërkimet e tij në arkivat ruse nuk ka hasur ndonjë dokument zyrtar për kohën ekzakte të emërimit të Ali Tepelenës në funksionin e Pashait në Janinë, megjithatë ai insiston duke iu referuar një dokumenti të Konsullit të Ruse në Korfuz, Liberaqi Benaqi, i cili ia drejton Këshillit të Ministrisë së Jashtme, më datë 2 Prill 1788, ku Ali Pasha përmendet si Pasha i Janinës. Por, në këtë dokument që paraqitet më poshtë, kemi një datë më të hershme nga ajo që ofron studiuesi rus, ku Ali Pasha prezantohet si Pasha, pra është fjala për datën 15 Mars 1788. Vlen gjithashtu të përmendim se dokumenti që kemi përparrë, megjithëse i vetëm, na bën me dije se Ali Pasha vazhdon të mbajë ende funksionin e Komandatit të kontrollit të derveneve, megjithëse ai ka marrë tanime një funksion tepër të lartë, atë të Pashait të një pashallëku të madh. Ky dokument i rëndësishëm i Ali Pashës, i Arkivit të tij, që bën të njohur i pari funksionin e Pashait është shfaqur vetëm së fundmi me botimin e këtij vëllimi.

Përmes këtij dokumenti të marrëveshjes që kem përparrë deklarohemi se jemi dakord, bëjmë të njohur dhe arsyetojmë të gjithë ne Sudenitë e poshtëm, të vegjël dhe të mëdhenj, se duke filluar nga sot me dëshirën tonë pranuam që fshati ynë të bëhet agaliki i të madhërishmit dhe



Ali Pasha

jetëgjatit dovletit (pushtetarit) Ali Pasha efendiu ynë, dyqind groshë, që të kujdeset për ne për çdo ankesë të fshatit, sa ndaj spahijve aq edhe për shpenzimet që japid. Kështu ne parashtruam kërkesat tona dhe kështu dhe e vërtetojmë. (me firmat tona - IK)

*Ikonomos vërtetoj
Prifti Harisi vërtetoj
Plaku Lakos vërtetoj
Prifti Jorgji vërtetoj
Donos Diamanti vërtetoj
Jani Mihu vërtetoj
Joti Jorgji vërtetoj
Luli Dono vërtetoj
Anagnosti eksarko vërtetoj
Papajani vërtetoj
Llazo Kallfa vërtetoj
Jani Platika vërtetoj
Joti Triko vërtetoj
Nikola Loli vërtetoj
Taci Zugrada vërtetoj
Taci Xhaveëlla vërtetoj*

Dokumenti Nr. 11

Servia, 17 Shtator 1791

Dokumenti me nr. 11 është një letër konfirmuese, e rajave të vilajetit të Servisë, drejtar Ali Pashës (Servia është krahinë në Greqinë veriore - IK). E sqarognë se do të vazhdojnë të respektojnë marrëveshjen që kanë bërë me të rreth ajanit të ri Haxhi Halil aga të porsaemëruar dhe se njojin kushtet penalizuese prej rreth pesë mijë groshësh, për shkak të të cilave "donin të shkonin me një tjetër aga". Në krye të dokumentit shënimi - përdorimi i fjalës "Neziri" (.... i ngarkuari) përdoret me një mënyrë të pasigurt dhe nuk arrijmë të kuqtojmë nëse i takon

Korrespondenca

Haxhi Halil agait apo Ali Pashës. Në rastin e dytë kur përdoret ky term arrijmë të kuptojmë se Ali Pasha emëron ajanin me cilësinë, funksionin e Nazirit të Derveneve.

Përmes kësaj shkrese bëjmë me dije se ne rajatë e vilajetit të Sërvisë respektojmë të madhërishtmin efendiu tonë Ali Pasha dhe kush kërkon që të dalë nga fjalë (marrëveshja) me Haxhi Halil ganë, të cilit ne ia dhamë fjalën dhe do të përpinqet të shkojë me tjetër aga dhe nënshkruan marrëveshje tjetër dhe i sjell ndonjë dëm Haxhi Halil agait dhe vilajetit, duhet të detyrohet t'i japë të madhërishimt pashait, efendiu tonë pesë mijë groshë atij njeriu, gjer më entizin.

1791 Shtator, Servia Xhimkas Aleziu pranojmë

Manolis Dhimitri pranoj

Pashkos pranoj

Nikos pranoj

(në krye është vënë shënimi:)

Neziri Selfixhe për Haxhi Halilaganë.

Dokumenti Nr. 12

Dokumenti me nr. 12 është një letër e Haxhi Petës drejtuar Ali Pashës. Në të mungon koha e hartimit të saj si dhe vendi ku ajo është përpiluar. Haxhi Petua, njeriu i Ali Pashës, ankohet për një bashkëpunim të keq me Veli Gjekën dhe me Tahir Qor-kanin, që duket se gjenden në të njëjtën krahinë. Fraza e shkruar në këtë letër "një varkë ka Tahiri gjer në Kastri", në lidhje me asgjësimin e dy Suljotëve dhe përmendja e Myftar Pashës në ato anë, na lejon të hamendësojmë në mënyrë të bazuar se bëhet fjalë përfushatën ushtarake kundër Sulit, më 1792, gjatë së cilës fitoi sigurisht Myftar Pasha por me humbje të konsiderueshme (Është fjalë për betejën e datës 20 Korrik). Dokumenti duhet të jetë shkruar mjaft ditë apo javë përpëra ditës së disfatës së Myftarit në rrjedhën e poshtme të Aherondës, (Lumë në Camëri - IK) dhe në terrenet e rrjedhës së lumit Vuvu, ku gjendet fshati Kastri dhe i vetmi liqen i vogël i zonës.

Varkat që përmënden në këtë dokument janë lanca të vogla të cilat përdoreshin për nevojat e frontit të luftimeve dhe qarkullo-nin nga brigjet e ku lumejtë Aheroni dhe Vuva derdhen në det pasi përshkrojnë fushat. Dokumenti është hartuar në kohën që Ali Pasha gjendej në këto anë, pas Shkurtit të vitit 1792. Fakti që Ali Pasha gjendet në territoret e frontit të luftimit të kësaj fushate dhe jo në Janinë, del nga fjalët e frazës së dokumentit, ku thuhet: " aty gjendet Memush agai dhe Mehmet Hoxha dhe do të bëjnë infande (=informojnë-IK)". Për zhvillimet e luftimeve, rrëthimin dhe sulmin e vitit 1792, si dhe për lëvizjet e Ali Pashës të kësaj kohe, nga Janina në frontin e luftimeve në betejat e Sulit, flet në studimin e tij, M. Psimuli: "Suli", f. 361-373.

I madhi-erishmi jetëgjatë pushtetar vezir, të përualem thellësisht dhe këmbët e tua të nderuara puth, lus zotin të të plotësojë çdo dëshirë të zëmrrës tënde, amin.

Unë e mora letrën tënde të nderuar dhe kuptova gjithcka më shkruaje, vë kokën time dhe familjen time në shërbim të pushtetit tënd, vetëm se u ndjeva ahamna (= i ligështuar, keq, turq.) prej Veli Gjekës dhe prej Tahir Qorkanit që më prekin dhe më kuptojnë njerëzit pasi ka edhe zotëria e jote plot shqetësimë që s'të lënë rehat. Po le të vejë Veli Gjeka me Nivicjotët dhe me Shënvasiljotët të zënë (të kapin) trimat e mij me besë nuk duhej, pasi jo vetëm hapin sytë e Romejve (grekëve, kristjanëve) dhe për dlijetë ngarkesa grurë që të bëri rixha (=t'u lut, turq.) Myftar Pasha, nëse dëshiron t'ja japësh mirë do të bësh. Unë mbetem përherë kurban i shtëpisë tënde dhe i zotërisë tënde, dhe ta dish se unë asgje nuk e dua me zor, vetëm me bekimin tënd dhe çfar i shërben pushtetit tënd unë jam në shërbim të pandërprerë.

Më shkruan dhe kërkon mendim për Tahirin, por unë nuk di ç'të tē them, prandaj vetëm ti shkruaj fermanin (=urdhërin me shkrim, turq.) dhe tē jesh i sigurt se ashtu do të bëhet, ti i di vetë mirë punët, prandaj atje ku mendon se bëhen më mirë punët, atje mbështetu.

Vetëm do të doja tē tē thosha që nëse do të vendosje Sadikun e Piluqit (Bilushit!) me disa njerëz të Shtëpëzit dhe bashkë me ta edhe Mehmet Hoxhën, ata do të tē bënin punë për madhi-erinë tënde, pasi ata janë tē gatshëm kudo që ti urdhërosh tē venë, kështu mendoj se duhet tē bësh, pasi unë nasipi (=mëndje, turq.) për punën tënde nuk dua tē tē jap.

Korrespondenca

Sa për dy varkat që kish për të marrë Veli Gjeka, i mori, ndërsa një varkë që kishte Tahiri në Kastri që i bën shërbim tanë ja dërgoi Veliut ta marrë barkat ose Tahiri të marrë barkën, të cilën e përdor për të mbajtur ujë, por ti e di si do ta shkruash fermanin (=urdhërin, turq.). Vetëm më vjen keq që ndërsa unë mbetem besnik në shërbimet e tua dhe nga ana tjetër të më ngacmojnë (të tallen) grekët, megjithatë unë do të vazhdoj të mbetem nën urdhërat e tua dhe ta dish, me dëshirën e perëndisë unë të qëndroj besnik në shërbimet e tua dhe të Myftar Pashës, as natën dhe as ditën për ju nuk fle. Dje, ditën e shtunë vramë dy Suljotë por megjithatë nuk aritëm ta shtiem në dorë vendin pasi aty ishin karavulin (=kullën, fortësën, turq.). Aty (tek ju) është Memush Agai dhe Mehmet Hoxha, të cilët mund të të informojnë për gjithçka tjetër rrëth meje që kam pasur këto kohë. Zoti të dhiëntë ty jetë të gjatë. Haxhi Petos
(d.v.)

Dokumenti Nr. 13

Janinë, 25 Janar 1792

Dokumenti i mëposhtëm, me nr. 13, është një letër lutëse e shkruar nga Mitropoliti i Janinës, Makarios, ai i Durrësit, Partheniu, administratorët apo kryepleqtë e Janinës, Zagorit dhe të "nahijeve të tjera...", në mbështetje të Ali Pashës. I adresohen një funksionari të lartë otoman të pa identifikuar në Kostandino-pojë, të cilit i luten të mos pranojë letrat e shkruara kohë më parë prej "Aishe Hanumit, gruaja e Sulejman Pashës", kundër Ali Pashës, pasi ato që shkruan ajo janë të pabaza. Nënvizojnë se Ali Pasha i ka kërkuar asaj që të "qëndrojë në rregull dhe me ndershshmëri në sarajet e saj" dhe të merret me "qehaja" (administratorin) e pasurisë së saj kudo ku ajo kërkon të qëndrojë, veç "Kastrinos" (Gjirokastrës) dhe Janinës.

Duke vazhduar me informacionin për Aishe Hanumin ata shtojnë: "...largojeni prej këtu që të mos mund të bëjë skandale të tjera më" dhe më tej akoma "që të ndërpresë së shkruari letra